



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.01.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.01.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " ALBI COMPANY " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-8206-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-104-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " ALBI COMPANY " SH.P.K., e dt.20.01.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-8206-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-104-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 16.01.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:16.01.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " ALBI COMPANY " SH.P.K., me dt.20.01.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-8206-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-104-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.01.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me marrëveshjen për makineritë në mes Operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe OE "PE-VLA-KU" sh.p.k.-Dega në Kosovë, nuk qëndron.

Në këtë marrëveshje ceket se të njëjtës i bashkangjitet lista e makinerisë që është pjesë e kësaj marrëveshje. Në ofertën e Operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, janë prezantuar marrëveshja në fjalë dhe lista e makinerisë e nënshkruar dhe vulosur nga "PE-VLA-KU" sh.p.k. dhe kjo plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues në FDT-ë dhe pretendimet e juaja lidhur me këtë pikë bien poshtë;

Pretendimi juaj lidhur me kontinierin për zyrë me WC, nuk qëndron, sepse Operatorit ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar WC siç është kërkuar në FDT-ë. I njëjti ka prezantuar faturë dhe kjo e mbulon kërkesën e FDT-së;

Sa i përket pretendimeve të juaja për Operatorin ekonomik "Alping" sh.p.k., Autoriteti kontraktues nuk do të lëshohet në shqyrtimin e tyre, sepse të njëjtin Autoriteti kontraktues e ka shpallur si të pasuksesshëm;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
